

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“JONNY BAU CONSTRUCTION” Sh.p.k.**

Z. Gazmir Rustemaj, shtetas shqiptar, lindur me date 12.09.1984, ne Bajram Curr, Shqiperi, mbajtes i kartës se identitetit shqiptare me Id: I40912043N.

E cila sot me date 17 Shkurt 2025 (dymijë e njëzete e pese), ka vendosur te nenshkruaje Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (me poshte “Shoqeria”), aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

Neni 1 - Emertimi

Emertimi i Shoqerise eshte “JONNY BAU CONSTRUCTION” Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqerise eshte ne Njesia administrative nr.7, Rruga Kongresi i Lushnjes, Pallati nr.20, Kati V, Apartamenti 23, Tirane, Albania.

Neni 3 - Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje periudhe te papercaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqerise

- 4.1 Shoqeria ka per objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi.
- 4.2 Ne menyre me specifike shoqeria ka per objekt social – Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e vilave private me teknologjine e fundit te ndertimit, ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesve, Ujrave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujtese, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit. rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike: si dhe cdo ndertim tjetër i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas nenit H2 te Kodit Civil per shkak te trpezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesën ku eshte vendosur.
- 4.3 Per permbushjen e objektivave te Shoqerise, kompania mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, te luajtshme dhe te paluajtshme qe perbejne nje gje te pershtatshme, mund te zoterojne aksione ne kompani te tjera, biznese, shoqata dhe konsorciume te cilat kane objekt aktiviteti te njeje apo te ngjashem.
- 4.4 Shoqeria mund te marre hua dhe te pranoje garanci reale ose personale ne favor dhe ne interes te paleve te treta dhe mund te marrin financime falas dhe pa pagese nga anetaret e saj, te gjitha sipas afateve dhe menyrave te ligjit dhe pa karakter prevalence, por vetem ne lidhje me arritjen e objektit dhe me perjashtimin e çdo veprimtari qe sjell mbledhjen e kursimit te tregut ose te nderhyrjes ne ndermjetesimin imobiliar, apo organizimin e tregjeve te transferuara ose ne çdo drejtim ne lidhje me publikun.

Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqerisë është 1,000,000 (nje milion) Leke.

5.2. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1 (nje) kuota, te gjitha e nenshkruara dhe te shlyer.

Neni 6 - Kontributet

6.1. Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar si me poshte:

 1

- Ortakia e shoqerise, **Z. Gazmir Rustemaj** ka ofruar nje kontribut ne para te barabarte me 1,000,000 Leke, nëpërmjet depozitimit prane nje banke ne Shqiperi.

6.2. Sipas kontributeve te mesiperme:

- **Z. Gazmir Rustemaj** i perket 1 (nje) kuote, qe i korrespondon me 100% (Njeqind perqind) te kapitalit te Shoqerise.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.

Neni 8 – Administrimi

- 8.1 Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator e cila eshte **Z. Gazmir Rustemaj**, shtetas shqiptar, lindur me date 12.09.1984, ne Shiperi, mbajtes i kartes se identitetit shqiptare I40912043N, i cili emerohet per nje periudhe prej 5 (pese),vitesh.
- 8.2 Administratori do te ushtrojne te gjitha kompetencat e administrimit te zakonshem, ne perputhje me parashikimet e nenit 95 te ligjit nr. 9901, date 14 prill 2008 “Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare” dhe nenit 14 te Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen te gjitha kompetencat e nevojshme per te kryer te formalitetet e permbushjen e detyrimeve te parashikuara per themelimin e Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi. Per kete qellim, Administratori, mund ti drejtohet per ndihme te treteve ose konsulenteve te cileve mund te delegojne ne teresi ose pjeserisht kryrjen e aktivitetit te siperpermendur.
- 8.4 Administratori i deleguar eshte gjithashtu i autorizuar te veproje ne emer te Shoqerise ne formim e siper deri ne regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Ai eshte gjithashtu i autorizuar, te firmosi te gjitha aktet dhe te marre persiper detyrime ne emer te Shoqerise qe rrjedhin prej momentit te regjistrimit te saj si edhe ka te drejte t’i delegoje kompetencat e tyre personave te tjere.

Neni 9– Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe.

* * *

Ortaku i shoqerise
“JONNY BAU CONSTRUCTION” SHPK

Z. Gazmir Rustemaj


 Gazmir Rustemaj